

**RAPORTI PERFUNDIMTAR I**  
**GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**PËR PROGRAMIN E STUDIMIT**  
**BACHELOR NË SHKENCATKOMUNIKIMI**  
**TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE**  
**“HËNA E PLOTË” (BEDËR)**

**Ekspertë:**

- 1. Prof.dr Hamit Boriçi***
- 2. Prof.as.dr. Mimoza Kore***

**Prill 2013**

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit**

**“Bachelor në Shkenca Komunikimi”**

**HYRJE**

**Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkencat e komunikimit**

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), i cili ofron programin “**Bachelor në Shkenca Komunikimi**” është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane. Në përputhje me “Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar me ligjin nr.10307, datë 22.07.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), departamenti i Shkencave të Komunikimit vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave të komunikimit, marrëdhënieve me publikun e medias (shih [shtojca 1](#))

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Prof.dr Hamit Boriçi
2. Prof.as.dr. Mimoza Kore

**ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**1. Misioni/Objektivat e programit të studimit**

*Misioni*

Misioni i departamentit të Shkencave të Komunikimit është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit dhe të marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetjen shkencore-kërkimore, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe ndjekin zhvillimet bashkëkohore në fushën e komunikimit, medias e të mbarë shoqërisë.

Objektivi: Departamenti nëpërmjet programeve e kërkimit shkencor do të përgatisë profesionistë të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe zhvillimi të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit e medias.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit parashtron një arsim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar ta ndërtojnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, në fusha të ndryshme të përcjelljes së informacionit me anë të mjeteve të ndryshme, si edhe në fushën e marrëdhënieve me publikun.

Programi “Bachelor në Shkenca Komunikimi” u ofron studentëve një formim intelektual, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e komunikimit.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi i IAL sipas standardit/ kriterit <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programet e studimit të “Bachelor në Shkenca Komunikimi” ishin hartuar në përputhje me misionin e Institucionit dhe qëllimin e tij për të krijuar një profil social në tregun e Arsimit të Lartë në vendin tonë.</p> <p>GVJvërejtë se programi i studimit “Bachelor në Shkenca Komunikimi”, ka objektiva të përcaktuara qartë. Këta Objektiva realizoheshin me anë të një gërsheetimi të mirë të dijeve dhe të praktikës profesionale të cilat ishin në përputhje me profilin e programit.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor në Shkenca Komunikimi” ishte hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, i cili me lulëzimin e tregut të medias vizive dhe asaj të shkruar ka shumë nevojë për gazetarë, publistë dhe punonjes së marredhënies me publikun të arsimuar mirë. Programet janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Në këtë aspekt, sektori i medias paraqitet si një ndër më prioritarët dhe më terheqësit për të rinjtë, me mundësi të mëdha punësimi (<i>Burimi: RVB, f. 6</i>)</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në</p>	<p>Programi “Bachelor në Shkenca Komunikimi” ofron mundësi të mira, që studentët të ndjekin edhe programe të tjera më të avancuara si MSC, duke u bërë bazë për zhvillimin strategjik të institucionit. Ky institucion ka si qëllim të bëhet një nga qendrat shkencore në vend në fushën e shkencave të komunikimit.</p> <p>Programi ishte hartuar duke pasur në bazë njohuri shkencore të përgjithshme mbi Gjuhën shqipe, Median, Historinë e Shqipërisë dhe Komunikimin. Jemi të mendimit që të shtohen orët e mësimit të Shqipësisë Standarde në program, sepse vihen re në media mangësi në këtë drejtim. Programi ofronte edhe mundësi të tjera, si krijimi i shprehive kompjuterike, të gjuhës së huaj, të kulturës politike etj</p> <p>Në procesin e përmirësimit të kurrikulës të rishqyrtohet kalimi i lëndëve “Komunikimi organizativ”, “Komunikimi politik” dhe “Komunikimi ndërkulturor e personal” nga grupi “njohuri formuese” - E – “lëndë me zgjedhje”, në</p>

<sup>1</sup>GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>“disiplina të formimit karakterizues –B-. Arsyetimi: mendojmë se këto disiplina lidhen me boshtin formues, përmbajtjen e programit “Shkenca komunikimi”.Në programin studimor të departamentit janë parashikuar 48 orë mësim në auditor dhe 57 orë punë të pavarur nga studentët. Koha tjetër të konceptohet dhe zbatohet si praktikum aktiv nga studentët nën drejtimin e pedagogut.Mendojmë se në auditor janë të mjaftueshme 15 orë. Sugjerojmë të rishikohet program I lëndë Gjuhë shqipe 1 dhe 2.(Burimi: Shtojca 10, Plani strategjik i shkollës së lartë dhe informacioni që na dhanë krerët e institucionit, RVB, f.52 Plani mesimor)</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  <b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Një ndër objektivat në planin strategjik është përditësimi i programeve mësimore dhe kërkimit shkencor sipas nevojave të tregut. Studenti që ndjek këtë program do të ketë mundësi punësimi: në institucione mediatike publike e private si gazetar i medias së shkruar e vizive. Studenti mund të punojë në organizma, organizata, shoqata vendase dhe të huaja, të cilat operojnë në fushën e edukimit/komunikimit, si operator kurator i marrëdhënieve ndërkombëtare, në administratën publike e private etj. Studenti mund të punojë në subjekte politike, në zyrat e shtypit dhe të informimit, në zyrat e marrëdhënieve me publikun, në institucione të huaja, në organizma të huaj etj.Nëpërmjet zyrës së medias , Rektorati mbante ne shqyrtim nevojat dhe drejtimet qe merrte tregu i punes, duke përcaktuar edhe planin strategjik për të ardhmen. Duke i kryer studimet në gjuhën shqipe dhe anglisht, kjo krijon mundësi që studentët të punësohen jo vetëm në tregun vendas, por edhe atë të huaj</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Institucioni kishte testuar kërkesat e mediave</li> <li>Në takim me stafin dhe drejtuesit verejtem se për vitin akademik të ardhshëm ishin në pritje të një numri më të madh studentësh. Kjo, lidhur me politikat e reja të MASH –it në lidhje me financimin e AL. Po kështu mjaft të rinj, kishin shfaqur interes për këtë fushë studimi në Bedër.</li> </ol> <p>Kreret e programit kishin dijeni per numrinmë të madh te studentëve në programe të tilla të ngjashme në institucione simotra (Burimi:Shtojca 10, Pika 2.2.1, f.7,Plani strategjik)</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve</p>	<p>Programet që ofron ky fakultet në nivelin Bachelor nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Shumë nga disiplinat lëndore të këtij programi theksojnë identitetin kombëtar. Programet e studimit promovojnë dhe ruajnë vlerat</p>

synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	kulturore kombëtare. Kjo arrihet nëpërmjet lëndëve të veçanta, por edhe me lektorë të promovuar në këto fusha (Burimi: Takimi me stafin, RVB f. 14-15)
<b>Konkluzione të GVJ: Do të sugjeronim një organizim më të mirë të programevetë studimit, të nivelit Bachelor në Shkenca e Komunikimit. Standardi plotësohet</b>	

## 1. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

### Tregues të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

## 2. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

### Tregues të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 1- 2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

<b>Fakulteti i Shkencave Humane - Departamenti i shkencave të komunikimit</b>					
<b>Personeli Akademik Efektiv (emër-</b>	<b>Detyra në departament</b>	<b>Titulli /grada</b>	<b>Personeli akademik me kontratë (emër -</b>	<b>Titulli/ grada</b>	<b>Institucioni ku punon me kohë të plotë</b>

<b>mblimësi)</b>				<b>mblimësi)</b>			
1	Ayhan Tekinesh	Përgjegjës i departamenti	Prof.dr.	1	Hasan Bello	Doktorant	Instituti i Historisë
2	Ramadan Çipuri	Zv.përgjegjës i departamentit	Doktorant	2	Jolanda Lila	Doktorante	Radio "Kontakt"
3	Brisedia Mema	Lektore	Prof .dr.	3	Alban Tartari	Doktorant	Eagle Mobile
4	Rahim Ombashi	Lektor	Prof. as. dr.	4	Bashkim Gjergji	Prof. as. dr.	Universiteti i Tiranës
5	Hajri Shehu	Lektor	Prof. dr.	5	Blendi Ceka	Doktorant	Universiteti i Tiranës
6	Emirjon Senja	Lektor	Msc.	6	Mirela Mersini	Dr.	Universiteti i Tiranës
7	Rudi Dunga	Lektor	Msc.	7	Mirdaim Axhami	Dr.	Universiteti i Tiranës
8	Ilda Shytaj	Lektor	Doktorante	8	Roland Zili	MA	Vizion+
				9	Mark Marku	Prof.as. dr.	Universiteti i Tiranës
				10	Eldon Gjikal	Dr	Universiteti i Tiranës
				11	Agron Tufa	Doc. dr	Universiteti i Tiranës
				12	Gentiana Skura	Prof.as. dr.	Universiteti i Tiranës
				13	Lutfi Dervishi	MA	
				14	Belfiore Qose	Doktorante	

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK)

<b>Titulli</b>	<b>Departamenti i shkencave të komunikimit</b>		
	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	<b>Raporti PAE/PAK</b>
Profesorë	3	0	3/0
Profesorë të asociuar	1	3	1/3
Doktorë	-	4	0/4
Pedagogë -doktorantë	2	4	2/4
Pedagogë me MA	2	2	2/2
Asistentë me Ma	0		
Asistentë pa Ma	0		
Personeli administrativ	0		

- Të dhënat sipas seksit

Titulli	Departamenti i shkencave të komunikimit		
	PAE : femra	PAE: Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	1	2	2/1
Profesorë të asociuar	0	1	1/0
Doktorë	0	0	0/0
Pedagogë doktorantë	1	1	1/1
Pedagogë (pa tituj) me Ma	0	2	2/0
Asistentë me Ma	0	0	0
Asistentë pa Ma	0	0	0
Personeli Administrativ	0	1	1

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i personelit akademik me kontratë me moshë.				
	Departamenti i Shkencave të Komunikimit :				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					
Profesorë të asociuar		1	1	1	
Doktorë	1	4			
Pedagogë doktorant	4				
Pedagogë me Ma		2			
Asistentë me Ma					
Asistentë pa Ma					

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat  
(Shtojca 23 II)
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Për programin “Bachelor në Shkenca Komunikimi”, 53 studentë / 10 pedagogë, pra mesatarisht 1 pedagog për 5.3 studentë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardit/ kriterit
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Në zyrën e personelit na u ofruan procedura transparente të rekrutimit të stafit, të cilat janë në përputhje me rregulloren dhe statutin e këtij Institucioni të arsimit të lartë. GVJ vuri re se për rekrutimin zbatoheshin procedurat ligjore, të përcaktuara sipas rregullore të bazuar në statutin e këtij institucioni. <i>(Burimi: neni 46, 47, 48, 49, 50, shtojca 2)</i> Këto procedura ishin të shfaqura edhe në ueb-in e institucionit.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë (PAE) ishte më pak se 70% e stafit të përgjithshëm të angazhuar për realizimin e programit. Personeli akademik PAE në krahasim me atë me kontratë (PAK) është në raportin 8/15</p> <p>Personeli akademik vleresohej periodikisht dhe në mënyrë transparente nga studentet dhe nga kolegët, nëpërmjet anketimeve dhe punës shkencore. Puna shkencore e stafit akademik shpërblehej edhe në vlera monetare. (Në zyrën e personelit u njohëm me mënyrën e rekrutimit dhe metodat e njoftimit për punë. U njohëm me raportet për vlerësimin e Aplikantit, drejtuar këshillit të administrimit. Ajo ishte në përputhje edhe me Rregulloren e Punësimit bazuar në statutin e këtij Institucioni. <i>(Burimi: statuti, shtojca 2; rregullorja për punësim dhe vlerësim, shtojca 6, f.3 dhe anketimet e studentëve, shtojca 26, zyra e burimeve njërezore dhe faqja e ueb-it)</i></p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p>Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme në lidhje me anëtarët e personelit si me kohë të plotë, ashtu edhe për ata me kohë të pjesshme, duke mbajtur një databazë në formë të printuar dhe atë elektronike, si dhe duke krijuar edhe arkivin e personelit. Dosjet e personelit ishin të plota. Diplomat e marra jashtë vendit ishin të</p>



<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve /moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>konvertuara ne MASH</p> <p>Zyra e personelit dhe shefi i departamentit dispononin listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ, si të printuar edhe në formë digjitale.</p> <p>Kur ka nevojë për personel të ri procedura e rekrutimit bëhet transparente në ueb-in e universitetit</p> <p>Personeli akademik i angazhuar ne realizimin e programit të ciklit të parë është staf i pajisur me tituj shkencorë, por që fillojnë nga grada shkencore Master- Profesor (Burimi: Zyra e burimeve njerëzore, sylabuset e lëndëve, shtojca nr. 25)</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>GVJ gjeti në institucion një staf ndihmës-mësimor të motivuar dhe mjaft të angazhuar në mirëmbajtjen e mjediseve. Gjithashtu GVJ verifikoi dhe vëzhgoi në vend se nuk ka laboratorë dhe personel përkatës për praktikimin dhe realizimin e orëve laboratorike të studentëve. (Burimi: vizitat në institucion)</p> <p>Objektivat e programit realizoheshin në mënyrë optimale nga burimet njerëzore. Stafi akademik, siç doli nga bisedat me studente e pedagogë, mbykqyrnin nga afër praktiken e studentëve. Kjo realizohej shumë mirë edhe për shkak të numrit jo të madh të studenteve. Ky kriter realizohej 1 pedagog për 5 studentë. (Burimi: takimet me stafin)</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni organizon në mënyrë periodike programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. Ishin organizuar disa konferenca shkencore që i shërbenin kualifikimit të stafit (Burimi: Puna shkencore e stafit dhe trevistat e botuara)</p> <p>Ne departament kishte një bazë të dhënash për të gjitha programet e ofruara duke i mbajtur ato në dy forma, si atë të printuar ashtu edhe në formë digjitale. (Burimi: Vizita në Departamente, gjenden edhe web)</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ: IGVJ mendon se institucioni i plotëson standardet e mësipërme</b></p>	

**3. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

### Tregues të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione

<b>Emri i auditorëve</b>	<b>Hapësira e brendshme (m2)</b>	<b>Kapaciteti</b>
301	90	56
401	90	56
501	90	56

- Klasa për seminare

Tabela 1-Klasat e përdorura gjatë vitit akademik 2011 – 2012 / 2012-2013

<b>Emri i klasës</b>	<b>Hapësira e brendshme (m<sup>2</sup>)</b>	<b>Kapaciteti</b>
302	40	26
303	40	26
402	40	26
403	40	26
502	40	26
503	40	26
601	24	18
602	40	28
603	40	24
604	20	12

- Salla për aktivitete promovuese
- Salla e konferencave (H1), kishte një sipërfaqe prej 200 m<sup>2</sup> dhe një kapacitet për 190 vende. Salla e konferencave është përdorur më shumë për veprimtari social-kulturore.
- Laboratorë për lëndët

Laboratorë informatike 402	laborator	24 kompjutera
-------------------------------	-----------	---------------

- Salla interneti  
Internet Ëireles ishte në çdo ambient të institucionit
- Salla për bibliotekë

Institucioni disponon një sallë biblioteke me 56 vende dhe me 23 518 tituj librash, shqip dhe në gjuhë të huaj

- Mjedis për fotokopjime, librari etj

Një printer dhe një qendër fotokopjeje janë vendosur në katin e parë të SHLHPB për studentët. Për printimin dhe fotokopjimin ofrohen zbritje çmimi për studentët.

- Zyrë informacioni për studentët

Kishte dy zyra informacioni për studentët

- Nyje hidrosanitare

Kishte 5 ambiente hidrosanitare

• **Infrastruktura e përmbledhur ne tabele**

Mjediset	Sasia	Sipërfaqja	Norma m <sup>2</sup> /për student
Salla për leksione	5	202.9	0.85
Klasa për seminare	1	96.2	0.4
Salla për veprimtari promovuese	1	268.6	1.13
Salla për praktikë lëndore / profesionale	0		
Laboratorë për lëndët	0		
Laboratorë informatike	1	44.6	0.18
Salla interneti	0		
Salla për bibliotekë	1	189	0.80
Mjedise për fotokopjime, librari etj	1	16	
Zyra informacioni për studentët	2	33	
Korridore /holle	2	250.4	1.06
Mjedise sportive	0		
Mjedise shërbimi për të tretë			
Mjedisi hidrosanitare për studentët	3	7.5	
Mjedisi hidrosanitare për personelin akademik	2	5.12	

Mjediset për stafin:

Mjediset për stafin	sasia	Sipërfaqja	Norma m <sup>2</sup> /për person
Zyrë për dekanin/zëvendësdekanin	1	30.9	
Zyrë për kancelarin	0		
Zyra për sekretarinë mësimore	1	25.9	
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	0		
Zyra për personelin akademik	3	70	1.3
Zyrë për financën	0		
Zyrë për Njësinë e SBC			
Salla për mbledhje	0		
Mjedis për stafin e shërbimit	0		
Mjedise për veprimtaritë e qeverisë studentore	0		
Mjedise çlodhëse, si kafeteri/ fastfood/ restaurant	1	120.5	0.35

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/ kriterit
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni vinte në dispozicion të studentëve tekste mësimore. Edhe studentet (nga biseda me ta) na thanë se kishin tekste për çdo lëndë. Nga sa vërejtëm në bibliotekë dhe nga sylabuset shumica e lëndëve mbulohej me leksione. Literatura ndihmëse ishte e pasur</p> <p>Biblioteka kishte 23 518 libra (sipas punonjeses) shumë që nuk përputhet me atë të raportit (35 000), megjithatë ishte literature e mjaftueshme dhe funksionale. Librat ishin në shqip, anglisht, turqisht e arabisht.</p> <p>Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, nga viti akademik 2012-2013 ishte mundësuar abonimi në bibliotekën online Jstore. Në sallën e leximit në bibliotekë ishin 20 titujsh gazetash të përditshme, kur 4 prej tyre ruheshin në arkivë. Zgjedhja e gazetave bëhej në bazë të tirazhit dhe numrit të kopjeve. Mungonin periodikë të huaj .</p> <p>Departamenti dhe shefi i tij merrte nga pedagogët e lëndës listen e literatures se nevojshme dhe ia bente kerkese Rektoratit, I cili përcaktonte buxhetin për të. Pasurimi i bibliotekës ishte nje nga synimet kreëve të institucionit</p> <p>Biblioteka ishte nje ambient i mbushur me studente, e cila ishte ne sherbim te tyre edhe pasdite. Ishte nje ambient i kendshem e plot drite e me libra te vendosur ne rrafte te arritshem e te aksesueshem nga studentet. Oraret e bibliotekës ishin të shfaqura në hyrje të bibliotekës, e cila ishte e hapur për studentët nga e hëna deri të shtunën, nga ora 8:00 deri në 17:00. <i>(Burimi: Vizita në bibliotekë dhe në departament, takimi me studente)</i></p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi</p>	<p>Institucioni dëshmonte se ka një sasi të mjaftueshme, zyrash, klasash, auditoresh, sallë konferencash. Kishte një laborator për mësimin e gjuhës së huaj. Përballë institucionit po ngrihej nje studio televizive dhe radioje (Qendra e Medias) ambientet e së cilës grupi i vizitoi (ishin duke i përgatitur) te cilat do t'iu shërbenin nga viti i ardhshëm studentëve të këtij drejtimi.</p> <p>Mjediset mësimore ishin të pajisura me mjetet e nevojshme dhe bashkëkohore, si: dërrasë interaktive, projektorë, kompjuter, internet. Të gjitha mjediset mësimore, ishin të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm. Në të gjitha ambientet e institucionit kishte wireles.</p> <p>Programet e ofruara nga SHLHPB nuk janë të natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Për të përmbushur nevojat e programeve ishte vetem Laboratori i Gjuhëve të Huaja, meqënëse një pjesë e programit mësimor zhvillohej në gjuhën angleze</p> <p>Në varësi të programeve të studimeve, institucioni disponontenjw sallw kompjuterash (24 kompjutera)</p>

<p>të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguishtikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Institucioni kishte mundësi me kapacitetet e tij të mbulonte një pjesë të praktikave profesionale, por synimi ishte kryerja e tyre jashtë vendit dhe në institucione të mediave jashtë institucionit. Gjatë vitit akademik 2011-2012, 21 studentë nga ky departament kanë kryer stazhin veror në Shqipëri dhe 6 studentë kanë kryer stazhin veror jashtë vendit, në Gjermani dhe në Turqi. Për të lehtësuar gjetjen e vendeve të praktikave për studentët, gjatë vitit akademik 2011-12, SHLHPB kishte nënshkruar tri marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat në Shqipëri, dy në Turqi dhe një në Gjermani, si dhe disa të tjera me kompani vendase. Ato janë: <i>world Media</i>, Frankfurt, Gjermani <i>Today's Zaman</i>, Stamboll, Turqi <i>STV</i>, Stamboll, Turqi <i>Qendra e Kurseve Meridian</i>, Tiranë, Shqipëri <i>Albtelekom Sh. A</i>, Tiranë, Shqipëri <i>Univers Alb. Sh. A</i> (American Hospital), Tiranë, Shqipëri. Praktika profesionale, konsiderohej nga studentet si pika më e fortë që vlerësonin.</p> <p><i>(Burimi: vizita në institucion dhe në qendrën që po ndërtohej dhe shtojca 24, 32)</i></p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b> <b>Standardet e mesiperme plotësohen nga ky institucion për të realizuar programin e nivelit Baccalor.</b></p>	

#### 4. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

##### Tregues të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

Ky Institucion Arsimor është Jofitimprurës, dhe mbështetet nga fondacioni arsimor

*Sema*

**Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (lekë)**

Të ardhurat nga:	Viti 1
<b>Fonde publike:</b>	
Pushteti qendror	0
Pushteti vendor	0
Gjithsej	0

<b>Fonde jopublike:</b>	
Grantet për kërkim dhe kontratat	0
Konsulencat, shërbimet	0
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	14,811,159
Sponsorizimet	0
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	50,589,655
Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj)	0
Gjithsej	
<b>SHUMA</b>	<b>65,400,814</b>

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja e përgjithshme për student ishte 606,012Euro/ 187 studentë, pra 3240 euro për student.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Ky institucion raportin e parë financiar do ta publikojë dhe dokumentojë në muajin mars 2013. (GVJ nuk e pati)

### Vlerësimi sipas Standardeve

<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Përmbushja e standardit/ kriterit</b>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Duke qene se është në vitin e dytë të veprimtarisë së tij akademike, ky institucion raportin e parë financiar do ta publikojë dhe dokumentojë në muajin mars 2013. (grupi ynë nuk e pati)</p> <p>Ky Institucion Arsimor është Jofitimprurës, dhe mbështetej nga fondacioni arsimor <i>Sema</i>.</p> <p>Institucioni dëshmonte qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet</p>	<p>Të tria këto kritre mbeten për t'u realizuar në të ardhmen. Duke qene institucion i ri (2- vjeçar) ende s'ka përpiluar një raport auditit</p> <p>Neve na u vu në dispozicion një pasqyrë e</p>

operative, etj.; <b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	të ardhurave ku pasqyrohej çdo e ardhur në këtë institucion
<b>Konkluzione të GVJ: Mendojmë se plotësohet standardi dhe kriteret e mësipërme. Institucioni ishte në gjendje që financiarisht të mbulonte zhvillimin e këtij program. Raportet që do të hartohen prej tij në të ardhmen do ta plotësojnë më mirë pamjen mbi këtë problem</b>	

## 5. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

### Tregues të matshëm:

- Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e KBSC	Detyra që ka në në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Bayram Karçi	Kryetar	27.02.2012
2	Ramadan Çipuri	Zv. Kryetar	27.02.2012
3	Prof. As. Dr. Rahim Ombashi	Anëtar	10.10.2012
4	Manjola Çollaku	Anëtar	
5	Arti Omeri	Anëtar	27.02.2012
6	Albi Koçibelli	Anëtar	27.02.2012
7	Nertil Bërdufi	Anëtar	10.10.2012
8	Enriketa Sögütlü	Anëtar	10.10.2012
9	Gentjan Skara	Sekretar	27.02.2012

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

- Etj
- ☑ Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- ☑ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- ☑ Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- ☑ Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/ kriterit
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> <li>d. Intervista;</li> <li>e. Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>b. Dëgjime në auditor;</li> <li>c. Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module,</li> </ol>	<p>Institucioni kishte përcaktuar qysh në statut mënyrën e vlerësimit. Ai përdorte instrumente si anketimet për të vlerësuar ecurinë e programeve. Megjithatë, do vërejtur se për afatin e shkurtër kohor (2 vjet) që po zbatohet ky program, në këtë institucion është shpejt të vleresohen te metat dhe anet pozitive që janë shfaqur. Nga ana tjetër, institucioni ka hartuar programe bashkohore duke sjelle edhe përvojat më të mira.</p> <p>Informacioni i kërkuar është përfshirë në raportin për vetëvlerësimin institucional</p> <p>Publikimi i rezultateve deri më tani është bërë brenda institucionit, në këshillin e fakultetit, i cili ia ka përcjellë Senatit. Rezultatet e vlerësimit që kanë bërë studentët iu vunë edhe grupit tonë në dispozicion</p> <p>Për vlerësimin, institucioni kishte përdorur metoda të drejtpërdrejta (si pyetje dhe diskutime me studentet), por dhe të tërthorta, si anketime anonime me studentët</p> <p>Anketimi me studentët ishte kryer para se ata të jepnin provimet, në mënyrë që gjykimi i tyre të ishte i pavarur.</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë implementuar në anketë</p> <p>Konferencat ishin edhe një metodë vlerësimi për pedagogët dhe i përkasin të performancës së tyre. Studentët vlerësoheshin në provime sipas sistemit amerikan ( A, B.), i cili konvertohej dhe sipas atij shqiptar me notë.</p> <p>Gjatë praktikës mësimore studentët vëzhgoheshin nga 1 pedagog që i shoqëronte</p>



<p>praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve /praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	
<p><b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>  <b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Akreditimi institucional, me sa pa GVJ, po kryhej në të njëjtën kohë në këtë institucion me vlerësimin në nivel programesh. Ky është vlerësimi i parë për Institucioni, megjithëse i ri, kishte hartuar politika të sigurimit të cilësisë. Për këtë kishte ngritur KVAZHC-në (Këshilli e vlerësimit Akademik dhe të zhvillimit të Cilësisë), KBSC-në (Komisioni i brendshëm të Sigurimit të Cilësisë) që ndiqnin zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë. Rezultati i kësaj pune ishte RVB, raporti i parë i vetvlerësimit.</p> <p>Megjithë kohën e shkurter të jetes se këtij institucioni, KBSC-ja e ngritur për këtë çështje, ka marre në shqyrtim cilësinë dhe e ka ndjekur atë në mënyrë periodike.</p> <p>Propozimet për ndryshim e programeve mësimore përcillen për në Senat duke pasur parasysh parimin hirarkik vertikal: departament-fakultet- rektorat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së menaxhimit të kurrikulave (<i>Burimi: Shtojca 2 : Statuti i Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër), Neni 15</i>).</p> <p>Departamenti ka analizuar rezultatet e anketimeve të cilat i qenë përcjellë Rektoratit. Në saj të tyre ishte marrë edhe masë ndaj një pedagogu, i cili ishte larguar nga institucioni.</p> <p>Rezultatet e anketave të vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës kishin dhënë të dhëna të rëndësishme sasiore e cilësore dhe janë marrë në konsideratë për rinovimin e kontratave me stafin akademik.</p> <p>Institucioni ka hartuar strategji për përmirësim të vazhdueshëm.Strategjia, politika dhe procedurat ishin të publikuara.(Burimi: Shtojca 10, shtojca 15 (vendim pwr ngritjen e GVB, takimi me studentwt, dhe zv. Shefin e departamentit)</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b>  <b>Të dy standardet e mësipërme plotësohen për këtë nivel programi</b></p>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 6. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

#### Tregues të matshëm:

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë
- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 5)

Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore												Provime			
			Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur		Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej
1	Lënda 1 (Ishte)																	
	Lënda 1 (u ndryshua)																	
2	Lënda 2 (Ishte)																	
	Lënda 2 (u ndryshua)																	
3	Lënda 2 (Ishte)																	
	Lënda 2 (u ndryshua)																	
..	...																	
Ndryshime në Total																		

**Shih Planet mësimore gjenden në raportin e vetevleresimit**

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'
- Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.
- Një vit akademik ka 60 ECTS

- Për leksionet \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 6)

	Lënda /Moduli	Pedagogu/ët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1.	Lënda 1				
2.	Lënda 2				
3.	....				

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

**Të gjitha këto gjendeshin në institucion si në dokumentacionin e bashkangjitur raportit (Shih Shtojca)**

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/ kriterit
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>GVJ konstatoi se studimet ishin organizuar në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohej në përputhje me programin e licensuar nga MASH.</p> <p>Studenti realizonte në një vit 1500 orë që konvertohen në 60 kredite. <i>(Burimi: Rregullorja e këtij programi, neni 10, RVB Planet mesimore, f. 48-49)</i></p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit gjithëinformacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve <i>Bachelor</i> që ofron. Informacioni gjendet edhe në sekretarinë mësimore dhe sekretarinë e Departamentit</p> <p>Njësitë që përmendëm më sipër japin të gjithë informacionin e nevojshëm për lëndët e detyruara dhe me zgjedhje</p> <p>Njësitë që përmendëm më sipër japin të gjithë informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, dhe rregulloren e ndjekies së mësimi Gjithashtu, studentët pajisen me sylabusin përkatës nga çdo lektor në fillim të semestrit.</p> <p>Informacioni mund të merret edhe nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit <i>(Burimi: takimi me studentët, vizita ne sekretarinë mësimore dhe takimi me stafin akademik)</i></p>
<p><b>Konkluzionet e GVJ:</b>  <b>Ky program i plotëson standardet e mësipërme</b></p>	

## 7. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

### Tregues të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
  - Leksione
  - Seminare
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj
- Format e kontrollit të njohurive
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

## 8. Studentët

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/ kriterit
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. <b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë ishte bërë sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. E përcaktuar edhe në Nenin 5 të rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve, gjatë përzgjedhjes së kandidatëve, që kanë mbaruar maturën shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve, ky institucion ka vënë si kriter bazë pranimi mesataren mbi 8 (tetë) të shkollës së mesme. Kandidatët që nuk e plotësojnë kushtin e lartpërmendur i nënshtrohen provimit të pranimit. Elementë të tjerë pranimi janë letra e motivimit, si edhe intervista me përgjegjës të departamentit. <i>(Burimi: RVB f.64, shtojca 28)</i>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve; <b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit; <b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës; <b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program	Nga takimi me studentet, konstatoam se ata ishin të informuar për gjithçka që kishte lidhje me programin e studimit Studentët vlerësonin pedagogun e lëndës në fund të semestrit, para provimit. Kjo bëhej nëpërmjet anketimeve. Gjatë intervistave me studentët, ata e vlerësonin marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunues me pedagogët Për çdo ankese note, sqaroheshin me pedagogun. Këtu funksiononte Dekani I studentëve, që shërbente si këshillues karriere dhe njëkohësisht si urë lidhëse për zgjidhjen e problemeve të studentëve, si dhe këshilltari akademik <i>(Burimi: RVB f. 64-65, takimi me student, shtojca 2 Anketa)</i> Lidhja e marrëveshjeve me institucionet tjera (veçanërisht mediatike) iu jepte mundësi studentëve të krijonin edhe lidhjet

studimi.	e së ardhmes me to. Nëpërmjet këshillimit të karrierës, leksioneve të hapura me personalitete të fushës, studentët informohen edhe për tregun e punës, megjithëse ende nuk kishim përvojat e para, sepse studentet e parë ishin në vitin II të studimit. <i>(Burimi: Takimi me studentët)</i>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Aktualisht, SHLHPB nuk ka të diplomuar. Në një plan afatshkurtër planifikohet ngritja e zyrës së të diplomuarve (Alumni) pranë dekanatit të studentëve, e cila do kryejë funksionet, që përmenden në kriter.</p> <p>Institucioni dispononte të dhëna të sakta për numrin e studentëve të regjistruar dhe të larguar. GVJ kontrolloi regjistrat themeltare, si dhe bëri krahasime edhe me procesverbale provimesh për student të rastësishëm.</p> <p>Në vitin e parë për këtë program studimi kishte: 26 studentë dhe 1 të ç'rregjistruar</p> <p>Në vitin e dytë për këtë program studimi kishte: 27 studentë</p> <p>Institucioni kishte arkivuar të dhënat e ecurisë së studentëve. Rezultatet e provimeve dhe të mbrojtjes së temave a detyrave ishin të arkivuara, dhe sic vumë re të sekretuara e të ruajtura (vendosur në rregullore) për 5-vjet. Zyra e këshillimit të karrieres se studenteve mund t'i merrte nga sekretaria mesimore në çdo kohe</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrieres se studenteve mund t'i merrte nga sekretaria mesimore në çdo kohe, të dhënat e mësipërme dhe të ndiqte ecurinë e studentëve.</p> <p>Në institucion, pamë studentë të dalluar që ishin evidentuar dhe ishin çuar jashtë për praktika</p>
<p><b>Konkluzionet e GVJ</b> GVJ mendon se Standardi plotësohet.</p>	

## 10 .KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/ kriterit
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b> <b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, në Departament nxitet bashkëpunimi ndërmjet personelit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Shkëmbimi i mendimeve reflektohet edhe në mënyrën e hartimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programit, i cili propozohet nga Këshilli i departamentit dhe pasi ka marrë aprovimin e Këshillit të Fakultetit, i dërgohet për miratim senatit akademik.</p> <p>Kompetencat dhe ndarja e detyrave të personeli është i parashikuar në Rregulloren e Organizimit Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësive përkatëse dhe analizën e vazhdueshme të punës së tyre dhe garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. <i>(Burimi: shtojca 5 Rregullore e organizimit administrativ)</i></p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti, për realizimin e programit ndiqte një strategji të hapur bashkëpunimi edhe partneriteti në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Ai, me institucionet arsimore të huaja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi duke ndjekur një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe për trajnime profesionale e stazhe studentore.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Prandaj, gjatë verës studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale. Gjatë vitit akademik 2011-12, 21 studentë nga ky departament kanë kryer stazhin veror në Shqipëri, por 6 studentë kanë kryer stazhin veror jashtë vendit, konkretisht në Gjermani dhe në Turqi Pranë SHLHPB është ngritur Qendra e Edukimit të Vazhduar dhe e Formimit Profesional, dhe janë organizuar një sërë specializimesh.</p> <p>Aktualisht, SHLHPB nuk e ka konsideruar si të domosdoshme marrjen e shërbimeve nga palët e</p>

	<p>treta, për realizimin e programeve të studimit, duke i plotësuar këto nevoja vete. <i>(Burimi: shtojca 24 Kopje e marreveshjeve të neshkruara, shtojca 32 Kërkesa drejtuar institucioneve të tjera)</i></p>
<p><b>Sipas GVJ standardi plotësohet.</b></p>	

## **ANALIZA PËRM BLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **a. Pika të forta:**

- 1) Programi mësimor “Bachelor në Shkencat e Komunikimit” është një program bashkëkohor që i pajis studentët me njohuri shkencore cilësore, duke i bërë të aftë për tregun e punës.
- 2) Ky program zhvillohet në një Institucion të Arsimit të Lartë që ka vizion dhe strategji të qartë të zhvillimit të tij, në kontekstin kombëtar e më gjerë. Në të është ndërthurur përvoja kombëtare me atë të huaj.
- 3) Departamenti i Shkencave të Edukimit, që ofron këtë program, është pjesë integrale e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), e cila gëzon statusin e një Institucioni Jofitimprurës, prandaj dhe besueshmëria ndaj tij është më e madhe për publikun dhe çdo investim shkon për cilësinë e mësimin.
- 4) Cilësia në hyrje është e mbështetur mbi një kriter të lartë siç është nota mesatare e pranimit mbi 8-të.
- 5) Ka një bashkëpunim të admirueshëm midis stafit akademik, studentëve dhe stafit ndihmës.
- 6) Në gjirin e stafit akademik kishte personel të kualifikuar. Disa prej tyre ishin nga zërat më të spikatur në fushën e medias.
- 7) Një pjesë e stafi akademik efektiv dhe me kontratë në departamentin e shkencave të komunikimit vinte nga vende të ndryshme si Francë, Turqi, SHBA etj.
- 8) Stafi akademik, i cili kishte mbaruar studimet jashtë vendit kishte diploma të njohura nga MASH.
- 9) Kërkimi shkencor ishte pjesë e punës së stafit akademik. Gjatë kësaj periudhe ka organizuar 5 konferenca ndërkombëtare, 2 kombëtare dhe disa Workshop-e. Konferencat kanë qenë me një pjesëmarrje të gjerë referuesish nga 19 vende të botës..
- 10) Botimi i një reviste ku pasqyroheshin aktivitet shkencore.
- 11) Numri i kufizuar i studentëve (53 për të dy vitet) dhe cilësia e tyre, është garanci për një proces mësimor cilësor dhe të kontrollueshëm lehtësisht.



- 12) Mësimdhënie jo vetëm në gjuhën shqipe, por dhe atë angleze (kjo e fundit edhe si disiplinë ekstrakurrikulare). Kjo iu jep mundësi studentëve për t'u përshtaur më mirë në tregun e punës
- 13) Provimet zhvilloheshin të sekretuara dhe arkivoheshin me rregullore për 5 vjet.
- 14) Institucioni kishte ngritur strukturën e vlerësimit dhe të monitorimit të cilësisë, i cili e ndiqte atë në vijimësi.
- 15) Transparenca dhe objektiviteti me të cilat ndeshesh në punën e këtij institucioni, duke filluar nga paraqitja online (programet, stafi, veprimtarite etj) e deri te dokumentacioni i plotë dhe i saktë.
- 16) Funksionimi i një rregulloreje të hartuar me kujdes.
- 17) Studentët ishin aktivë në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë (vlerësimin e programeve, pedagogut dhe hartimit të raportit të vetëvlerësimit )
- 18) Studentët ishin pjesëmarrës në aktivitetet shkencore që kishte organizuar Universiteti.
- 19) Në ndihmë të procesit mësimor vjen një bibliotekë me një infrastrukturë shumë të mirë, e cila përveç librave të ofron dhe librari online.
- 20) Një nga pikat e forta ishte praktika profesionale, për të cilën departamenti kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda e jashtë vendit. Studentët e pyetur ishin shumë të kënaqur prej saj.
- 21) Në universitet kishte një laborator kompjuterash, i cili ishte i frekuentueshëm nga studentët në çdo kohë si dhe ishte duke përfunduar studio e radios dhe ajo televizive (Qendra e medias dhe komunikimit) e cila nga sa vërejtëm, po ndërtohej me të gjithë parametrat bashkëkohorë dhe do t'iu shërbejë shumë studentëve që nga viti i ardhshëm.
- 22) Në çdo ambient të institucionit studentët kishin akses për internet.
- 23) Sekretaria mësimore kishte staf ndihmës të përkushtuar dhe dispononte dokumentacion të rregullt.

**Pika të dobëta:**

- 1) Institucion i ri. Kjo sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor që ofron qëndrueshmëri dhe besueshmëri.
- 2) Stafi akademik efektiv është më pak se 70%.
- 3) Kishte ndonjë disiplinë në të cilën stafi mësimdhënës duhej të ishte më i përshatshëm me fushën e studimit.
- 4) Programi i disiplinës Gjuhë shqipe 1 dhe 2 ka vend për përmirësim
- 5) Mungesa e teksteve bazë në disa disiplina

- 6) Ndihen ende mungesa në bibliotekë.
- 7) Mungesa ende e një raporti financiar

**Mundësitë:**

- 1) Organizimi dhe funksionimi i mirë i të gjitha hallkave institucionale.
- 2) Staf i ri, i përkushtuar dhe me eksperiencë ndërkombëtare
- 3) Puna sistematike shkencore e stafit akademik dhe përpjekjet e institucionit për t'i mbështetur.
- 4) Zgjerimi i kapacitetve infrastrukturore
- 5) Rekrutime të mëtejshme të stafit të brendshëm cilësor

**Pengesat:**

- 1) Të qenit institucion i ri.
- 2) Mungesa e tradites dhe e përvojës në përballje me tregun e punës.
- 3) Aspekti kohor (një dhjetëvjeçar) për kualifikim shkencor të duhur të SAE

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof.dr. Hamit Boriçi

Prof.as.dr Mimoza Kore